

Titulli i projektit: Bashkëpunimi zhvillimor ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Agjencisë Suedeze të Tatimeve (STA).

Afati kohor i projektit: Nëntor 2022- 2025, shtyrë për 31 mars 2026.

Projekti i asistencës së ofruar nga administrata tatimore e Suedisë, që filloi me Fazën Fillestare 2021-2022 (*Inception Phase*), dhe vijon me zbatimin e projektit gjatë periudhës 2022-2025, me një shtyrje për 31 mars 2026.

Marreveshja mes DPT dhe Administratës Tatimore Suedeze, u nënshkrua në *1 Nëntor 2022* në ambjentet e MFE-së, në prani të Drejtorit të Përgjithshëm, Ambasades Suedeze në Tiranë, SIDA-s dhe Ministrit të Financave.

Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në Shqipëri (*DPT*) dhe Agjencisë Suedeze të Tatimeve (*STA*) synon të forcojë mobilizimin e të ardhurave të brendshme. Bashkëpunimi trevjeçar do të financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (*Sida*).

Objektivi kryesor i Projektit është të mbështesë DPT-në në arritjen e zhvillimit dhe progresit të nevojshëm bazuar në MTRS 2022-2026. Projekti do të mbështesë këto përpaparime duke u fokusuar në forcimin e qeverisjes së mirë, pajtueshmërisë vullnetare dhe zhvillimit të biznesit brenda DPT.

Nëpërmjet llogaridhënies, transparencës dhe efikasitetit besimi i tatimpaguesve në sistemin tatimor dhe administrimin e tij do të rritet. Kjo do të çojë në rritjen e gatishmërisë së tatimpaguesve për të përmbushur vullnetarisht, duke reduktuar në të njëjtën kohë mundësinë e evazionit fiskal, i cili do të çojë në rritjen e të ardhurave tatimore. Ky projekt do të kontribuojë në mënyrë indirekte në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE) dhe do të vendosë bazat për adresimin e rekomandimit të Komisionit Evropian sipas Kapitullit 16 (Taksimi) në lidhje me gatishmërinë për të aplikuar sistemet e Teknologjisë së Informacionit (IT) të BE-së, si Vlera e Shtuar e Sistemit të Shkëmbimit të Informacionit Tatimor (VIES).

Projekti përbëhet **nga pesë komponentë** :

1. Ofrimi i shërbimit cilësor për tatimpaguesit.
2. Ndërtimi i një kulture të fortë integriteti.
3. Gjurmimi i mashtrimit tatimor.
4. Kontroll tatimor më efikas.
5. Asistencë në përdorimin e Shkëmbimit Automatik të Informacionit në çështjet tatimore.

Gjatë vitit të parë të Projektit (2022-2023), kemi realizuar 10 misione, 6 vizita studimore, 17 takime online, 4 webinare, pjesëmarrje në një seminar rajonal të mbajtur nga STA ne BiH, 1 seminar për menaxhimin e ndryshimit dhe 2 takime të Komitetit Drejtues.

Gjatë vitit të dytë të Projektit (Tetor 2023-2024) janë realizuar 2 vizita studimore ne Suedi për komponentin e Kontrollit Tatimor, 15 Misione fizike në Tiranë, 11 Takime digjitale dhe 2 Webinare.

Në vitin e 3-të të projektit (Tetor 2024- Nentor 2025), janë realizuar: 7 misione, 1 vizitë studimore ne Suedi, 7 takime dixhitale me komponentet dhe 1 webinar

2 takime të Komitetit Drejtues.

- 1 (një) vizitë studimore me Ekipin Menaxherial dhe DP, ne 24-28 Shkurt 2025.
- 1 Joint mission me të gjithë komponentet e projektit në shtator 2025.
- **Webinar dypalësh për shkëmbim njohurish** - Në prill 2025 u organizua një seminar online dypalësh ndërmjet Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Shqipërisë, i cili mundësoi shkëmbim njohurish mbi operacionet e call center-it ndërmjet dy administratave tatimore.
- **Webinar mbi fiskalizimin në Shqipëri, në maj 2025.** Administrata tatimore shqiptare prezantoi zbatimin e fiskalizimit në Shqipëri, për Agjencinë Tatimore Suedeze. Prezantimi theksoi përmirësimin e mbledhjes së TVSH-së, uljen e informalitetit, faturimin elektronik në kohë reale dhe forcimin e pajtueshmërisë, si dhe aspekte kyçe të zbatimit, si bashkëpunimi me ofruesit e software-ve dhe komunikimi me bizneset.

Në 8-10 Prill 2025, u organizua Seminari Rajonal, me përfaqësues të amministratave tatimore te rajonit, si Kosova, Bosnja Hercegovina, Serbi, Mali Zi, Maqedoni e Veriut. Seminari u zhvillua në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorinë e Kontrollit tatimor.

Rezultatet e pritura të projektit dhe ndikimi :

- ~ U miratua Plani Integritetit për DPT dhe Drejtorinë Rajonale (Dhjetor 2024)
- ~ Është zhvilluar dhe testuar në përdorues të vërtetë, një prototip i thjeshtë në letër shërbimi elektronik, "**Tax Test**" për informimin e tatimpaguesve per DIVA.
- ~ Një sondazh i dytë u zhvillua në prill –maj 2025, "*Citizens and Business Survey about Taxes* " me fokus parësor nevojat e tatimpaguesit; kjo punë prodhoi bazën e prokurimit për një përmirësim teknik dhe sqaroi ndikimet organizative.
- ~ DPT sëbashku me STA, ka hartuar dhe draftuar Strategjinë e Shërbimit Tatimpaguesve;
- ~ Gjithashtu në kuadër të Shërbimit tatimpaguesve, nevojat për Call Center janë bërë më të qarta. Për këtë STA ka përfunduar procedurat e tenderimit për një software të ri për Call Center. Kompania Fituese ka instaluar softwarin në Drejtorinë e Call Centerit, ne Drejtorinë Rajonale Tiranë.
- ~ Në kuadër të Kulturës së Integritetit, janë zhvilluar trajnime edukuese me stafin në Drejtorinë Rajonale Tatimore në Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Vlorë , Berat, Lezhë, Shkodër, Dibër, Kukës, etj. mbi Planin e Integritetit, Kodi Etikës, Sinjalizuesit dhe Konflikti Interesit në Administratën Tatimore.
- ~ Puna e Auditit të Brendshëm, rifilloi në fillim të vitit 2025. DPT dhe STA realizuan tre aktivitete prioritare që u fokusuan në dilema korrupsioni, sfida në rolin e Auditit të Brendshëm dhe kontributin e auditit/këshillimit në luftën kundër korrupsionit. Punëtoritë prodhuan njohuri të përbashkëta dhe rrugë praktike përpara, të mbështetura në Standardet Globale të Auditit të Brendshëm.

Në të gjithë komponentët, bashkëpunimi ka kontribuar jo vetëm në produkte teknike, por edhe në rezultate të rëndësishme “soft” që janë thelbësore për ndryshim institucional të qëndrueshëm. Ndryshimet në sjellje janë të dukshme në mënyrën se si stafi angazhohet, bashkëpunon dhe aplikon mënyra të reja pune. Ekipeve tregojnë gjithnjë e më shumë hapje, besim të ndërsjellë dhe përgjegjësi të përbashkët për rezultatet, duke reflektuar një zhvendosje graduale drejt një kulture më të orientuar nga të nxënit dhe llogaridhënia.

“Të mësuarit duke vepruar” dhe reflektimi i strukturuar kanë luajtur rol qendror në forcimin e kapaciteteve individuale dhe kolektive. Përdorimi i modeleve “train-the-trainer” dhe metodave të të nxënit aktiv kanë përmirësuar aftësitë e lehtësimit, sigurinë dhe ndjenjën e pronësisë tek stafi i DPT-së. Në disa fusha, ekipet tashmë dizajnojnë dhe realizojnë trajnime e seminare në mënyrë të pavarur, gjë që tregon ulje të varësisë nga ekspertiza e jashtme dhe rritje të aftësisë së brendshme për të mbështetur ndryshimin në kohë.

Bashkëpunimi ka kontribuar edhe në përmirësimin e bashkëpunimit ndër-funksional brenda DPT-së. Grupet e punës në fusha si CRM, Shërbimi ndaj Tatimpaguesit dhe AEOI/CRS raportojnë klimë komunikimi më konstruktive dhe kuptim më të mirë të ndërvarësive ndërmjet drejtorive. Mbledhjet e rregullta të komitetit të riskut dhe puna e përbashkët mbi pilotimet kanë forcuar një perspektivë më holistike mbi pajtueshmërinë dhe shërbimin, duke mbështetur qeverisje dhe vendimmarrje më koherente.

Zhvillimi i shërbimit web “Tax Test” ilustron gjithashtu sesi metodat e thjeshta, user-centric dhe iterative mund të sjellin rezultate dhe ndryshim sjelljeje. Prototipimi i hershëm, përfshirja e përdoruesve realë dhe testimi i shpejtë mundësuan korrigjime të hershme dhe ulën riskun e zhvillimit.

Në nivel drejtues, angazhimi i qartë i menaxhimit të lartë (“tone-at-the-top”) ka mbështetur ndryshimin e sjelljes. Menaxherët po veprojnë gjithnjë e më shumë si lehtësues të të nxënit, dialogut dhe inovacionit, duke kontribuar në një mjedis ku lejohen eksperimentimi, reflektimi dhe institucionalizimi gradual i metodave të reja. Integriteti, gjithëpërfshirja dhe orientimi nga përdoruesi janë internalizuar progresivisht përmes punës me dialog mbi integritetin, nismave të gjuhës së thjeshtë dhe aktiviteteve për ndërgjegjësim gjinor, duke ndikuar si në qëndrime ashtu edhe në praktika të përditshme.

Gjithashtu, bashkëpunimi dypalësh dhe rajonal në Ballkanin Perëndimor rezultoi shumë i vlefshëm. Seminaret rajonale, shkëmbimet dypalëshe dhe takimet e përbashkëta ofruan njohuri konkrete dhe praktike, si dhe mundësuan krahasim të qasjeve ndërmjet administratave që përballen me sfida të ngjashme reforme. Këto ndërveprime forcuan rrjetet profesionale, lehtësuan të nxënit nga kolegët (peer learning) dhe theksuan rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar në fusha si kontrolli, menaxhimi i riskut të pajtueshmërisë dhe shërbimi ndaj tatimpaguesit. Ky bashkëpunim rajonal kontribuon në praktika më konsistente, mësim të ndërsjellë dhe reziliencë institucionale afatgjatë, duke forcuar kontributin e projektit në zhvillimin e kapaciteteve të qëndrueshme përtej nivelit kombëtar.